# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6001
E premte, 14 shkurt 2020
çmimi 0.40 €


## Ministrja Bajrami siguron rektorët se politika nuk do të ndërhyjë asnjëherë në punën e universiteteve FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


"EPOKA E RE" JEP MIRËNJOHJE PËR TË GJITHË GAZETARËT QË KANË QENË DHE JANË PJESË E SAJ FAQE 4-5

# "EPOKA E RE" FESTOI 20-VJETORIN E THEMELIMIT DHE NUMRIN 6 000



Gazeta "Epoka e re" të enjten ka festuar 20-vjetorin e themelimit dhe numrin 6000. Në ceremoninë festive, e cila është mbajtur në ambientet e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, kanë marrë pjesë vetëm gazetarë e ish-gazetarë të këtij mediumi. Botuesi i "Epokës së re", Muhamet Mavraj, ka falënderuar të gjithë ata të cilët kanë qenë dhe janë pjesë e kësaj gazete. Me këtë rast, ai ka thënë se asnjëherë nuk do ta harrojë kontributin e secilit që ka punuar në gazetën "Epoka e re". Në përfundim të këtij takimi, "Epoka e re", në shenjë falënderimi për bashkëpunim, u ka dhënë nga një mirënjohje të gjithë gazetarëve që kanë punuar në këtë medium që nga themelimi e deri më tani FAQE 6-7

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR TË ENJTEN SEANCË PLENARE

## Kuvendi formon 14 komisione parlamentare

Vetëm pas konsensusit të parë pozitë-opozitë është bërë i mundur, në seancën e së enjtes, votimi i komisioneve parlamentare. Zvogëlimi i numrit të komisioneve parlamentare nga 16 sa ishin në 14 sosh është përkrahur me 90 vota për. Fillimisht, votimi i komisioneve ka dështuar, ndërsa në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit është arritur konsensusi pozitë-opozitë

### AKTUALE



**POMPEO: HEQJA E TAKSËS DHE MARRËVESHJA ME SERBINË TË JENË PRIORITET** F. 2

**PRISHET KOALICIONI LV - LDK NË PRIZREN** F. 10

**AZIZ BICI, DREJTOR I ZYRËS PËR ÇËSHTJE TË KATEGORIVE TË DALA NGA LUFTA E UÇK-së** F. 3

**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS NËNSHKRUAN DY MARRËVESHJE ME HOMOLOGËT MAQEDONAS** F. 11

### EKONOMI

**LUFTIMI I EKONOMISË JOFORMALE TË MBETET PRIORITET NË AGJENDËN E QEVERISË** F. 9

**PREMTOHET PËRKRAHJE PËR AGROBIZNESET VENDORE** F. 9

### KULTURË

**VEPËR QË SHUHET PËR VLERA TË VEÇANTA SHKENCORE** F. 12

Sadri FETIU

### SPORT

**YLLI KALON EDHE BASHKIMIN, KUALIFIKOHET NË FINALE** F. 12


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Palmer: E ardhmja e Shqipërisë dhe Maqedonisë ë Veriut është në Evropë

PRISHTINË, 13 SHKURT - Përfaqësuesi i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor Matthew Palmer, deklaroi se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut të ardhmen e tyre e kanë në Evropë dhe se ai shpreson shumë që Bashkimi Evropian do t'i hapë negociatat me të dyja shtetet në muajin e ardhshëm.
"ShBA-ja shpreson shumë që të BE-ja t'i hapë negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ne mendojmë se të dyja shtetet e meritojnë. Mendojmë se ky është një sinjal i rëndësishëm për t'ia dërguar rajonit. Mendojmë se është thelbësore që si Shqipëria, ashtu edhe Maqedonia e Veriut të kenë një rrugëtim evropian dhe një perspektivë evropiane", tha Palmer për "Radion Evropa e Lirë" në Bullgari.
Gjatë intervistës, ai akuzoi Rusinë se kërkon një Ballkan Perëndimor të përçarë, në mënyrë që të parandalojë integrimin në BE dhe të krijojë një pengesë të madhe të rajonit me Perëndimin.
Ai shtoi se ky objektiv është i kundër me vizionin që ShBA-ja ka për Ballkanin Perëndimor, ku të mbizotërojë paqja, prosperiteti dhe integrimi në familjen evropiane.



# Pompeo: Heqja e taksës dhe marrëveshja me Serbinë të jenë prioritet

**Në letrën e urimit dërguar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, thekson se është koha për vendosjen e marrëdhënieve normale me Serbinë që kanë në qendër njohjen e ndërsjellë, ndërsa kërkon heqjen e tarifave prej 100 për qind ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina**



Prishtinë, 13 shkurt - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, i shkroi letër urimi kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në të cilën thekson se është koha për vendosjen e marrëdhënieve normale me Serbinë që kanë në qendër njohjen e ndërsjellë, ndërsa kërkon heqjen e tarifave prej 100 për qind ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina.
"I uroj qytetarët e Kosovës për zgjedhjet e suksesshme dhe demokratike. E mirëpresim formimin e Qeverisë së Kosovës dhe presim që të punojmë së bashku, për t'i çuar përpara qëllimet e përbashkëta në rritjen e zhvillimit ekonomik, sundimin e ligjit dhe normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë", thuhet në letrën e sekretarit Pompeo, ka njoftuar voa.
"Tani është koha të kuptoni se normalizimi gjithëpërfshirës i marrëdhënieve me Serbinë, që ka në qendër njohjen e ndërsjellë, është thelbësor për integrimin e plotë ndërkombëtar të Kosovës. Shtetet e Bashkuara do t'ju qëndrojnë në krah, në përkrahje të këtij procesi", shkruan në letër sekretari Pompeo duke nënvizuar se "heqja e tarifave për prodhimet nga Serbia dhe Bosnja, do të jetë e rëndësishme për kthimin e palëve në tryezën e negociatave. Shpresojmë dhe presim që ju do ta bëni këtë gjë përparësi dhe do të përfitoni nga situata e krijuar pas dy letrave të qëllimit për të vendosur linjën ajrore dhe hekurudhore në mes të Prishtinës dhe Beogradit".
Diplomatët amerikanë e kanë shtuar trysninë ndaj qeverisë së re për heqjen e tarifave e cila ndërkaq është zotuar ta bëj një gjë të tillë, por duke kushtëzuar heqjen e tarifave me vendosjen e masave të reciprocitetit të plotë me Serbinë, ndonëse ende është e paqartë se si do të realizohet një synim i tillë.
Në nëntor të vitit 2018, Qeveria e Kosovës vendosi tarifat prej 100 për qind ndaj mallrave serbe në shenjë kundërshtimi ndaj qasjes së Beogradit ndaj shtetësisë së Kosovës. Beogradi kushtëzon vazhdimin e bisedimeve për normalizim marrëdhëniesh me Kosovës me heqjen e këtyre tarifave, por qeveria e ish-kryeministrit Ramush Haradinaj refuzoi çdo përpjekje të diplomacisë perëndimore për ta bindur për një gjë të tillë.
Opozita nuk pajtohet me planet e kryeministrit Kurti për heqjen e tarifave madje Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, paralajmëroi këtë javë se "do t'i përdorë të gjitha mjetet demokratike për të penguar heqjen e tarifave".
Menjëherë pas formimit të qeverisë së Albin Kurtit, ambasadori amerikan Richard Grenell, i dërguar i posaçëm amerikan për bisedimet Kosovë – Serbi, tha se "pret që tarifat të hiqen menjëherë".
Çështja pritet të diskutohet edhe gjatë Konferencës së Sigurisë në Munih që i zhvillon punimet nga 14 deri më 16 shkurt e në të cilën do të marrë pjesë edhe sekretari Pompeo.

## Meta: Ndryshimi i kufijve nuk është kurrë zgjidhje



TIRANË, 13 SHKURT - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta mbajti të enjten një fjalë përshëndetëse në ceremoninë e organizuar nga Ambasada e Kosovës në Tiranë, me rastin e 12-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.
Kreu i Shtetit Shqiptar tha se në Ballkan çdo popull e çdo komb është shumicë në një shtet dhe pakicë në një shtet tjetër, por sipas tij, zgjidhja nuk është kurrë ndryshimi i kufijve, por vetëm respektimi i njëjtë i standardeve evropiane të çdo pakice. Sipas tij, nuk ka popull të keq e të mirë, por ka politikë të mençur dhe politikë vrastare.
"Nuk ka popull të keq dhe popull të mirë, por ka politikë të mençur, vizionare, dhe politikë vrastare e shkatërruese. Kjo është e vlefshme për të gjithë vendet e të gjithë popujt. Në Ballkan, çdo popull e çdo komb është shumicë në një shtet dhe është pakicë në një shtet tjetër dhe zgjidhja kurrë nuk mund të jetë ndryshimi i kufijve, por respektimi i njëjtë i standardeve evropiane të çdo pakice në çdo vend. Na mbetet ta bëjmë rajonin tonë më të fortë, më të besueshëm, e mbi të gjitha më atraktiv, në Shqipëri, Kosovë, Serbi, Mal të Zi. Është koha të zgjidhet problemi mes Kosovës dhe Serbisë, ashtu siç u zgjidh mes Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë. Në zemër të një marrëveshjeje dhe normalizimi mes Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë njohja e ndërsjellë mes dy vendeve. Kjo do bënte një çlirim të jashtëzakonshëm të energjive pozitive në gjithë rajonin tonë", tha presidenti Meta.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Mbahet konferenca “Universiteti, politika dhe vlerat themelore të arsimit të lartë”

# Ministrja Bajrami siguron rektorët se politika nuk do të ndërhyjë asnjëherë në punën e universiteteve



**Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, ka siguruar të enjten rektorët se politika nuk do të ndërhyjë asnjëherë në punën e universiteteve siç ka ndodhur në të kaluarën. “Ju siguroj se do të përkujdesemi që t’i vëmë bazat me ligj, që politika t’i mbajë duart larg nga universiteti”, ka thënë ajo, duke shtuar se arsimi do të jetë prioritet i Qeverisë edhe nga ana buxhetore, edhe nga aspekti i qeverisjes transparente dhe të përgjegjshme**

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 SHKURT - Të enjten është mbajtur konferenca “Universiteti, politika dhe vlerat themelore të arsimit të lartë”, e organizuar nga Konferenca e Rektorëve, në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 50-vjetorit të Universitet të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Në këtë konferencë ka marrë pjesë edhe kryeministri Albin Kurti dhe ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami. E pranishme ishte edhe shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova dhe ambasadorë e përfaqësues të tjerë diplomatikë.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se historia e zhvillimit të Universitetit të Prishtinës është e lidhur ngushtë me historinë e popullit tonë në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. “Është kënaqësi dhe privilegj të jem këtu me ju sot, në këtë moment të arritjes historike të Universitetit të Prishtinës. Historia e zhvillimit të Universitetit të Prishtinës është e lidhur ngushtë me historinë e popullit tonë në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Një periudhë e ndryshimeve të mëdha nëpër të cilën fati i Universitetit ishte i lidhur ngushtë me fatin e popullit, sepse Universiteti i dha dijen e nevojshme një gjenerate e cila do të definonte të ardhmen e vendit e për pasojë edhe të vet Universitetit”, ka deklaruar Kurti.

Ai ka thënë se kështu, më shumë edhe se vend i dijes, Universiteti ishte vend i rezistencës, vend ku çlirohej vullneti i ndrydhur; vend ku akumulohej energjia për t’u përballur me padrejtësinë.

“Sa më shumë që rritej presioni nga regjimi i atëhershëm për ndalimin e studimeve tona, aq më shumë kërkonim liri për të studiuar, e sa më shumë që studionim aq më shumë e ndienim mungesën e lirisë. Kështu, masat e dhunshme të qershorit të vitit 1991, për ta ndaluar mësimin në gjuhën shqipe, do të sfidoheshin me shkollat-shtëpi, me shtëpitë-shkolla, me universitete nëpër shtëpi, ashtu siç më 1997 do të sfidohej i gjithë regjimi shtypës. Në gusht të vitit 1991 Gani Bajrami u kishte dërguar një letër organeve të dhunshme të Fakultetit të Makinerisë në Prishtinë, duke përfunduar me fjalët: ‘Mos harroni se për fatin e një populli, pa vullnetin e tij, mund të vendoset me forcë vetëm për një kohë dhe jo edhe për gjithë’. Bajrami ishte inxhinier i diplomuar dhe asistent. Kështu edhe ndodhi, e kështu ndodhë sepse vullneti i popullit nuk imponohet”, është shprehur ai.

Kurti ka pohuar se sot kur kremtojmë 50-vjetorin e Universitetit të Prishtinës, aq sa e kujtojmë me shumë nderim themelimin, po aq edhe rifillimin. “Sepse, rifillimi i Universitetit të Prishtinës në vitin 1991 nuk ishte më pak i vështirë sesa ai i themelimit në vitin 1970. E në këtë vit të reflektimit e festimit të Universitetit për këtë gjysmëshekulli, është mirë të kujtojmë e nderojmë një nga figurat kyçe të tij, i cili refuzoi nënshtrimin dhe imponimin e të tjerëve mbi Universitetin. Atë i cili i dha shumë vendit e pa të cilin Universiteti nuk do të ishte i tillë. Në këtë vit, më 16 prill, profesor Ejup Statovcit do t’i shënohet 80 vjetori i lindjes, e ne si institucione e kemi për obligim që ta nderojmë figurën e tij ashtu siç ai e meriton. Urtësia e mësimet e tij të shumta na udhëzojnë ende në vështirësitë tona që nuk janë të pakta”, Kurti.

Ministrja Hykmete Bajrami ka përgëzuar UP-në për 50-vjetorin e themelimit, ndërsa ka përmendur kontributin e profesorëve dhe studentëve për ngritjen dhe fuqizimin e UP-së. “Mirënjohja për ata duhet të shpërblehet me punën e ndershme që e kemi obligim secili prej nesh”, ka thënë Bajrami dhe më pas ka theksuar rolin e Universitetit në të gjitha zhvillimet në Kosovë përgjatë pesë dekadave të fundit, ndërsa tha se sot Universiteti i Prishtinës dhe të gjitha universitetet publike e private duhet t’iu përgjigjen kërkesave të së sotmes.

Ministrja Bajrami siguroi rektorët se politika nuk do të ndërhyjë asnjëherë në punën e universiteteve siç ka ndodhur në të kaluarën. “Ju siguroj se do të përkujdesemi që t’i vëmë bazat me ligj, që politika t’i mbajë duart larg nga universiteti”, tha ajo, ndërsa theksoi se arsimi do të jetë prioritet i Qeverisë edhe nga ana buxhetore dhe nga aspekti i qeverisjes transparente dhe të përgjegjshme.

Ministrja Bajrami shpalosi edhe programin e Qeverisë së Kosovës për arsimin e lartë ku, ndër të tjera, theksoi se do të rishikohet Ligji për Arsimin e Lartë, do të rithemelohet Këshilli Kombëtar i Shkencës dhe, krahas kësaj, do të themelohet dhe fuqizohet Fondi Kombëtar i Shkencës, ashtu edhe Fondi i Ekselencës.

Duke qenë se tashmë Ministrisë i është bashkëngjitur edhe Inovacioni, ministrja Bajrami theksoi se do të punohet bashkë me UP-në dhe universitetet e tjera për ta fuqizuar inovacionin në vendin tonë sepse, siç u shpreh ajo, në këtë mënyrë përmbushet objektivi ynë që idetë inovative, hulumtimet shkencore, të vihen në funksion të zhvillimit të gjithëmbarshëm të Republikës së Kosovës.

## Aziz Bici, drejtor i Zyrës për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e UÇK-së

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER)- Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar Aziz Bicin, këshilltar politik të tij dhe drejtor të Zyrës për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Me këtë rast, kryeministri Albin Kurti, Bicit, i ka uruar suksese në detyrën e re duke mirëpritur këshillat e tij politike, derisa ka kërkuar rol konstruktiv dhe përgjegjshmëri të lartë si drejtor i Zyrës për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR TË ENJTEN SEANCË PLENARE

# Kuvendi formon 14 komi



**Vetëm pas konsensusit të parë pozitë-opozitë është bërë i mundur, në seancën e së enjtes, votimi i komisioneve parlamentare. Zvogëlimi i numrit të komisioneve parlamentare nga 16 sa ishin në 14 sosh është përkrahur me 90 vota për. Fillimisht, votimi i komisioneve ka dështuar, ndërsa në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit është arritur konsensusi pozitë-opozitë**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 13 SHKURT - Kuvendi i Kosovës të enjten ka votuar pro zvogëlimit të numrit të komisioneve parlamentare nga 16 sa ishin në 14 sosh. Kjo është bërë e mundur vetëm pas një konsensusi në mes të pozitës dhe opozitës. Komisionet janë votuar vetëm pasi me 91 vota për është votuar vlefshmëria e Rregullores së Punës së Kuvendit për legjislaturën e shtatë, deri në miratimin e rregullores së re, me përjashtim të paragrafit 4 të nenit 69. Kjo pikë është propozuar nga deputeti i PDK-së, Memli Krasniqi. Më pas, me 90 vota për dhe asnjë abstenim është votuar formimi i 14 komisioneve parlamentare. "Me 90 vota për, asnjë kundër dhe një abstenim kalon edhe propozimvendimi për funksionalizimin e komisioneve parlamentare sipas propozimit të kryesisë", ka njoftuar kryeparlamentarja Vjosa Osmani

Seanca për formimin e komisioneve fillimisht kishte dështuar, kjo pasi votimi nuk ishte i vlefshëm për shkak të mungesës së kuorumit. Kjo bëri që kryeparlamentarja Vjosa Osmani ta thërrasë mbledhjen e Kryesisë për të diskutuar rreth kësaj çështje, ku dhe u arrit konsensusi i parë pozitë-opozitë në këtë legjislaturë.

Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, nënkryetari i Kuvendit nga radhët e PDK-së, Memli Krasniqi, ka treguar se pas shumë diskutimeve në këtë mbledhje janë pajtuar që t'i votojnë komisionet. "Sot në seancën e nisur paradite ne si deputetë të opozitës theksuam domosdoshmërinë e respektimit të plotë të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe nevojën e domosdoshme të kohezionit politik, në mënyrë që Kuvendi të mund t'i konstituojë trupat e veta punuese, pra formimin e komisioneve parlamentare", ka thënë Krasniqi. Sipas tij, konsensusi u bë i mundur vetëm pasi u morën parasysh kritikat e tyre. "Pas shumë diskutimeve, ku u evidentuan shkarjet e Rregullores së Punës dhe pas dështimit të votimit pa arritur kohezionin politik, tani në mbledhjen e sotme të Kryesisë vërejtjet tona u morën parasysh dhe tani besoj kemi pajtim të plotë për rrugën që duhet ta ndjekim së bashku për ta mundësuar votimin e suksesshëm të komisioneve parlamentare", ka deklaruar Krasniqi.

### Opozita ia miraton kërkesën e parë Qeverisë Kurti

Me 100 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i

## Presidenti Thaçi udhëtoi për Gjermani, merr pjesë në Konferencën e Sigurisë në Munih

Prishtinë, 13 janar (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka udhëtuar të enjten për në Gjermani, ku do të marrë pjesë në Konferencën e Sigurisë së Munihut. Në margjinat e Konferencës së Sigurisë së Munihut, presidenti Thaçi do të ketë takime të ndryshme bilaterale, ndër të tjera, edhe me senatorët amerikanë Ron Johnson dhe Chris Murphy, me ndihmëssekretarin e Departamentit të Shtetit, Philip Reeker, pastaj me drejtorin politik të Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, Richard Moore, si dhe me ministrin e Jashtëm të Sllovakisë, Miroslav Lajçak. Po ashtu, presidenti Thaçi në kuadër të kësaj konference do ta takojë edhe të dërguarin e posaçëm të Presidentit Trump për dialogun Kosovë - Serbi, ambasadorin Richard Grenell.



# sione parlamentare



Kosovës ka miratuar kërkesën e Qeverisë së Kosovës për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars. Shefi i Grupit Parlamentar i LV-së, Rexhep Selimi, ka propozuar që të miratohen ndarjet buxhetore për muajin mars. "Kërkoj mocion procedural për zgjatjen buxhetore për muajin mars të vitit 2020. Për shqyrtimin e këtij propozim vendimi kërkohet votimi për shmangie nga afatet procedurale, pra deklarimi me votim për shmangiet nga afatet procedurale", ka thënë Selimi.
Ky propozim është përkrahur edhe nga LDK-ja dhe partitë e tjera opozitare, PDK-ja, AAK-ja, dhe koalicioni Nisma-AKR.

## PDK-ja var në Kuvend fotografinë e presidentit në seancë

Pas fillimit të seancës parlamentare të së enjtes, Partia Demokratike e Kosovës e ka varur fotografinë e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, prapa karriges së kryetares së Kuvendit, Vjosa Osmani, e cila ka zhvendosur fotografinë e presidentit Thaçi nga zyra e vet në Kuvendin e Kosovës. Këtë veprim e ka bërë deputeti i PDK-së, Mërgim Lushtaku.
Ndërsa nënkryetari i Kuvendit nga radhët e PDK-së, Memli Krasniqi, ka treguar arsyet e këtij veprimi. "I kemi dërguar (Vjosa Osmanit) letër zyrtare në emër të Grupit Parlamentar. Pakënaqësia jonë ndaj saj si kryetare ka të bëjë me shkeljet ligjore. Përmirësimi i shkeljes ligjore s'ka ndodhur. Në mungesë të përmirësimit të shkeljes nga Vjosa Osmani, ne kemi në seancë fotografinë e presidentit të Kosovës", ka thënë Krasniqi pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit.



## Këto janë 14 komisionet parlamentare

Sipas Rregullores së Kuvendit, legjislatura e shtatë do t'i ketë katër komisione të përhershme dhe 10 funksionale. Komisionet e përhershme janë: Komisioni për Buxhet dhe Financa; Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim; Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi; dhe Komisioni për Integrime Evropiane.
Ndërsa komisionet funksionale janë: Komisioni për Punë të Jashtme; Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte; Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion; Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale; Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media; Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri; Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione; Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike; Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë; Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës; Komisioni për Mandat, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit.

## Jusuf Thaçi, zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

**Prishtinë, 13 shkurt (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar Jusuf Thaçin zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Duke i uruar punë të mbarë, kryeministri Kurti ka thënë se përgatitja profesionale e Thaçit do t'i ndihmojë shumë Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe se kontributi i tij në këtë institucion është shumë i nevojshëm.



## Diskutohen modalitetet e bashkëpunimit mes Qeverisë dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës

**Prishtinë, 13 shkurt (ER)**- Zëvendëskryeministri i parë i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të enjten në një takim pune drejtorin ekzekutiv të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahimi.
Në këtë takim është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit mes Qeverisë së Kosovës dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës si përfaqësues i vetëm i pushtetit lokal të Kosovës.
Në këtë takim po ashtu janë debatuar edhe modalitetet e bashkëpunimit dhe kyçjes së përfaqësuesve të Asociacionit të Komunave të Kosovës në grupet e punës ku diskutohen aktet ligjore që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale në mënyrë që zbatimi i tyre pas konsultimit me komunat do të jetë më efikas dhe në funksion të nevojave të qytetarëve.



“Epoka e re” jep mirënjohje për të gjithë gazetarët që kanë qenë dhe janë pjesë e saj

# “Epoka e re” festoi 20-vjetorin e themelimit dhe numrin 6 000

Gazeta “Epoka e re” të enjten ka festuar 20-vjetorin e themelimit dhe numrin 6000. Në ceremoninë festive, e cila është mbajtur në ambientet e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, kanë marrë pjesë vetëm gazetarë e ish-gazetarë të këtij mediumi. Botuesi i “Epokës së re”, Muhamet Mavraj, ka falënderuar të gjithë ata të cilët kanë qenë dhe janë pjesë e kësaj gazete. Me këtë rast, ai ka thënë se asnjëherë nuk do ta harrojë kontributin e secilit që ka punuar në gazetën “Epoka e re”. Në përfundim të këtij takimi, “Epoka e re”, në shenjë falënderimi për bashkëpunim, u ka dhënë nga një mirënjohje të gjithë gazetarëve që kanë punuar në këtë medium që nga themelimi e deri më tani





Prishtinë, 13 shkurt (ER) - Gazeta e përditshme “Epoka e re” ka shënuar 20-vjetorin e themelimit dhe numrin 6 000. Në ceremoninë festive, e cila është mbajtur të enjten në ambientet e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” kanë marrë pjesë vetëm gazetarë dhe ish-gazetarë të “Epokës së re” të cilët kanë evokuar kujtime që nga themelimi i kësaj gazete.

Fillimisht të pranishmit i ka përshëndetur botuesi i “Epokës së re”, Muhamet Mavraj.

Ai ka thënë se asnjëherë nuk do ta harrojë kontributin e secilit që ka punuar në gazetën “Epoka e re”. “Ju kam thirrur për t’ju përqafuar secilin një nga një dhe për t’ju thënë se nuk ju kam harruar dhe nuk ju harrojmë as sot as juve që keni marrë rrugë prej më të ndryshmeve qoftë në profesion, qoftë në profesionin dytësor, institucione shtetërore, institucione private, por gati secili prej jush nuk jeni ndarë nga mediat. Jam shumë krenar kur ju shoh juve në ekranet më të forta të Kosovës dhe të rajonit”, ka thënë Mavraj.

Ai ka thënë se nuk janë mbledhur në një tubim zyrtar, por në një ndejë shoqërore dhe kolegiale. “Nuk kemi thirrur parti politike, nuk kemi thirrur institucione dhe nuk kemi thirrur askënd që nuk punon dhe nuk ka punuar në ‘Epokën e re’ ose që është në ndonjë funksion politik qoftë në Kosovë, Shqipëri apo kudo. Ju jeni më të rëndësishëm se të gjithë ata që i keni nëpër mendje”, ka thënë Mavraj. As në këtë jubile, Mavraj nuk ka harruar ta falënderojë redaktorin teknik, Shkëmbim Krasniqi, i njohur si “Daja”, i cili nuk ka shënuar asnjë mungesë në punë. “Mos m’u hidhëroni, por ‘Daja’ është i veçantë”, ka thënë Mavraj.



Ndërsa drejtori i gazetës “Epoka e re”, Sadik Zeqiri, ka lexuar dy urime që kanë ardhur në adresë të “Epokës...” për 20-vjetorin e themelimit nga presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta dhe lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti.

Kurse Arsim Sinani, i cili më herët ka qenë redaktor i “Epokës së re”, ka thënë se kjo gazetë në çdo proces ka kryer detyrën kryesore që është informimi, por edhe komentimi i ngjarjeve dhe zhvillimeve, duke i vënë në situatë të vështirë politikanët dhe aktorët e politikës në Kosovë. “Por, qëllimi i këtij brezi duhet të kuptohet drejt se jemi brez i cili kurrë nuk ka bërë







# Xhavit Haliti: Sa shumë kujtime dhe emocione që na ngjallë ky përvjetor i "Epokës..."

Ish-nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, aktualisht zyrtar i lartë i PDK-së, Xhavit Haliti, ka uruar gazetën e përditshme "Epoka e re" për daljen në treg të numrit të 6000-të dhe 20-vjetorin e themelimit të saj. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se gazeta "Epoka e re" eci krah për krah me Kosovën e lirë, demokratizimin, shtetshpalljen e shtetndërtimin saj. "Para disa ditësh i ka mbushur 20 vjet. Sa shumë kujtime dhe emocione që na ngjallë ky përvjetor i saj! 'Epoka e re', përherë shembull i guximit në mbrojtje të lirisë, jo vetëm të shtypit, por edhe të vlerave të liribërjes së Kosovës, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të faleminderit 'Epoka e re'! Suksese të mëtejme dhe vazhdo të mbetesh e re!", ka shkruar Haliti.

kompromise në dëm të vendit të vet, pavarësisht prej kërcënimeve dhe situatave të turbullta që i kaluan dhe kalojnë shqiptarët", ka thënë Sinani.
Në këtë ceremoni ka folur edhe kryeredaktori i "Epokës së re", Mal Qorraj. Ai ka thënë se ndihet i nderuar që për 13 vjet është pjesë e kësaj gazete. Qorraj ka falënderuar të gjithë ata gazetarë që për këto 20 vite, në kohë të ndryshme, kanë dhënë kontribut në rrugëtimin e "Epokës së re" si dhe botuesin Muhamet Mavraj i cili për këto vite e mbajti gjallë këtë gazetë.
Në anën tjetër, ish-kryeredaktori i "Epokës së re", Burim Etemaj, ka folur për sfidat nëpër të cilat ka kaluar "Epoka" gjatë kohës sa ai ka qenë pjesë e saj. Etemaj ka bërë me dije se ishte "Epoka e re" ajo që e pra e kishte botuar Planin e Ahtisaarit, i cili i kishte paraprirë shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt të vitit 2008.
Edhe ish-kryeredaktori i "Epokës së re", Erenst Luma, ka folur për 20-vjetorin e themelimit të kësaj gazete dhe botimin e numrit të 6000 mijtë të saj. Ai ka thënë se puna në "Epokë..." mbetet një kapitull i veçantë në jetën dhe punën e tij. "20 vjet, 6000 numra dhe vetëm një epokë. 'Epoka e re', një kapitull i veçantë i jetës dhe punës sime. Përvojë, nder, krenari e identitet që më përcjellë gjithmonë e kudo mua dhe, sigurisht, secilin prej atyre që ishin pjesë e kësaj të veçante të medies dhe publicistikës shqiptare", ka thënë Luma.
Për rëndësinë e "Epokës së re" ka folur miku i saj dhe veprimtari Ismet Sylejmani.
Ai ka thënë se "Epoka e re" ka vlera të jashtëzakonshme kombëtare. Sylejmani ka thënë se "Epoka..." i ka dhënë mbështetje çdo procesi nëpër të cilin ka kaluar Kosova dhe kombi shqiptar. Ai ka thënë se "Epoka e re" si paraardhëse e "Botës së re", i ka dhënë përkrahje të çmuar edhe luftës së UÇPMB-së në Luginë të Preshevës dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni. Po ashtu, në këtë ngjarje ka folur edhe ish-gazetari i "Epokës së re", Bajram Lani, i cili tani punon në "Radio Kosova". Me këtë rast, ai ka thënë se i mungon aroma e gazetës. "Aroma e këndshme që sjellë gazeta e shtypur me mungon edhe sot", është shprehur Lani.
Gjithashtu, në ceremoninë e 20-vjetorit të themelimit të "Epokës..." kanë folur edhe ish-gazetarët Demir Reshiti, Alban Zeneli, Muhamet Jahiri, Arsim Lani, Agim Muhaxheri, Prend Buzhala, Jeton Mulsiu, Fatmir Bytyqi, Minire Berisha-Tërbunja etj.
Në fund të kësaj ceremonie "Epoka e re" në shenjë falënderimi u ka dhënë nga një mirënjohje të gjithë gazetarëve që kanë punuar në këtë medium që nga themelimi e deri më tani. Po ashtu, me mirënjohje "post mortem" janë nderuar edhe gazetarët e cilët kanë punuar në "Epokën e re" dhe që nuk janë në mesin tonë.

# Deputetja Musliu: Plot emocion dhe kujtime në 20-vjetorin e gazetës më të guximshme shqiptare

Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, ka uruar gazetën e përditshme "Epoka e re" për 20-vjetorin e themelimit dhe të numrit 6 000. Ajo përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka postuar një fotografi me gazetën "Epoka e re", të numrit të sotëm. "Plot emocion dhe kujtime në 20-vjetorin e gazetës më të guximshme shqiptare. 6 000 numra, 6 000 dritare plot dritë mbi historinë më të lavdishme të kombit tonë. Faleminderit që me guxim sfiduat propagandat më të ulëta dhe më intriguese të cilat helmonin opinionin çdo ditë me urrejtje patologjike! Urimet më të mira e suksese të pandalshme!", ka shkruar deputetja Musliu.




















# Luftimi i ekonomisë joformale të mbetet prioritet në agjendën e qeverisë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 SHKURT - Institucionet publike nevojitet ta fuqizojnë partneritetin me komunitetin e bizneseve drejt luftimit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal, duke synuar krijimin e një mjedisi me trajtim të barabartë dhe sa më të mirë afarist në vend. Kjo u konkludua në një tryezë të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe kompania "Ernst & Young", ku përfaqësues të bizneseve patën mundësinë të diskutojnë me ministrin e Financave dhe drejtorin e përgjithshëm të ATK-së mbi praktikat jo të ndershme ekonomike.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, gjatë këtij takimi theksoi se qeveria duhet ta përkrahë Administratën Tatimore në fuqizimin e kapaciteteve inspektuese, duke u siguruar që të gjitha bizneset deklarojnë tatimet e tyre në mënyrë të duhur. Ai foli mbi rëndësinë e luftimit të ekonomisë joformale, duke e përmendur se edhe në dokumentin e Planit të Rritjes së Odës Amerikane për qeverinë e re, Oda ka përfshirë luftimin e kësaj ekonomie si njërin prej prioriteteve që duhet të zë vend të lartë në agjendën e qeverisë të re.

Ndërsa Dairida Metalia, Menaxhere e Taksave në "Ernst & Young", tha se prania e ekonomisë joformale në fusha të ndryshme të aktivitetit ekonomik, e cila, sipas statistikave, arrin në mbi 30 për qind të BPV-së, është një ndër sfidat kryesore me të cilat përballet Kosova.

Ministri i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi, ka potencuar se partnerë kyçë të institucioneve publike në luftimin e ekonomisë joformale është komuniteti i bizneseve dhe konsumatorët. Sipas tij, sa i përket kësaj forme të ekonomisë, kontribut bukur të mirë në rritjen e së njëjtës ka dhënë sektori publik, duke e konsideruar ministrinë të cilën ai tash e drejton si ndër aktorët më përgjegjës.




Ministri Bislimi u shpreh se ekonomia joformale ushqehet përmes përpjekjeve jo të mjaftueshme për të siguruar formalizim të ekonomisë, gjersa hapi i parë që garanton suksesin në luftimin e saj është pohimi se në të kaluarën kemi dështuar.

Bislimi ka konsideruar se problem në vete është edhe matja e vëllimit të ekonomisë joformale. Ai ka përmendur se është qasje e gabuar të etiketohen vetëm disa sektorë relativisht më të ndjeshëm për shkak se joformaliteti është i dëmshëm pavarësisht në çfarë sektori shfaqet.

Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, ka thënë se tashmë është krijuar një traditë e zhvillimit të bashkëpunimit mes institucionit që ai përfaqëson dhe komunitetit të bizneseve, i cili padyshim po sjell ndryshime pozitive.

Murtezaj shtoi se gjatë 20 vjetëve të funksionimit të ATK-së si institucion, por edhe të zhvillimit të bizneseve, konsideron se ka avancim të theksuar në të dyja palët, si nga ana e bizneseve në rritjen e vetëbesimit në ATK për të deklaruar dhe paguar detyrimet tatimore, ashtu edhe në stafin e ATK-së, i cili në krahasim me një të kaluar me profesionalizëm të vobektë, po shkon gjithnjë duke u zhvilluar dhe vetëdijesuar. Sipas tij, rezultimi i një hendeku tatimor kaq të madh është i papranueshëm për ATK-në si institucion, pavarësisht se është në nivel më të mirë në krahasim me disa vende të rajonit.

Murtezaj ka theksuar se Administrata Tatimore e Kosovës ka përgjegjësi ligjore për zvogëlimin në minimum të nivelit të evazionit fiskal dhe se në bashkëpunim të ngushtë me bizneset synon ta gjejë çelësin e këtij problemi.

Në diskutimin e hapur me biznese u fol edhe për nevojën për promovim të transaksioneve elektronike në vend të atyre me para të gatshme, duke e përkrahur këtë edhe me infrastrukturë ligjore adekuate.

# Banka Botërore vazhdon ta mbështetë bujqësinë e Kosovës



PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka pritur të enjten në takim një delegacion të Bankës Botërore, i kryesuar nga menaxheri i Zyrës së BB-së në Kosovë, Marco Mantovanelli, me të cilët ka biseduar për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë në Kosovë si dhe për format e bashkëpunimit të mëtejmë në këtë sektor.

Ministri Mustafa e ka njoftuar delegacionin e Bankës Botërore për objektivat dhe prioritetet e ministrisë për këtë vit, të cilat ka theksuar se kanë për qëllim fuqizimin e mëtejmë të sektorit të bujqësisë në vend. Me këtë rast, ministri ka shprehur gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit me BB-në për realizmin e projekteve konkrete në bujqësi, njëkohësisht i ka falënderuar ata për mbështetjen që kanë dhënë deri më tash në sektorin e bujqësisë.

Ndërsa menaxheri i BB-së, Marco Mantovanelli, vlerësoi zhvillimet e deritashme në avancimin e sektorit të bujqësisë në vend dhe rikonfirmoi gatishmërinë e Bankës Botërore për mbështetjen e mëtejmë të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë.

# Premtohet përkrahje për agrobizneset vendore

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER)- Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka pritur në një takim përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës, të cilët i ka njoftuar me disa nga prioritetet e ministrisë në kuadër të programeve mbështetëse për agrobizneset për vitin 2020.

Mustafa ka treguar se MBPZhR-ja përmes programeve mbështetëse për agrobizneset vendore, synon rritjen e prodhimtarisë bujqësore, zëvendësimin e importit dhe rritjen e eksportit të këtyre produkteve, si dhe përmirësimin e aftësive konkurrueseve të agrobizneseve.

Ai i ka falënderuar përfaqësuesit e kësaj ode dhe ka konfirmuar gatishmërinë e tij për bashkëpunim të mëtutjeshëm me qëllim të zhvillimit të mëtejmë të agrobizneseve.

Nga ana tjetër, kryetari i bordit të Odës së Afarizmit të Kosovës, Skënder Krasniqi, e uroi ministrin për detyrën e re dhe e falënderoi për gatishmërinë e tij për bashkëpunim. Po ashtu, ai e ka njoftuar ministrin për zhvillimet e përgjithshme në sektorin e agrobizneseve në vend.



# Gjashtë të arrestuar për mashtrim, dhënie të ryshfetit dhe keqpërdorim të pozitës

Në tri lokacione të ndryshme dhe në tri raste të ndara, Policia e Kosovës, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK), ka arrestuar gjashtë të dyshuar, nën dyshim për përfshirje në veprimtari penale, mashtrim, dhënie të ryshfetit dhe keqpërdorim të pozitës

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 SHKURT - Policia e Kosovës, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK), në tri lokacione të ndryshme, në tri raste të ndara, ka arrestuar gjashtë të dyshuar, nën dyshim për përfshirje në veprimtari penale. Sipas njoftimit për media, në rastin e parë pas hetimeve paraprake, pas grumbullimit të provave të nevojshme, pas pranimit të Urdhër Kontrollit të lëshuar nga Gjykata Themelore - Ferizaj, të enjten policia ka realizuar planin operativ "Kontrabanda", ku janë kontrolluar katër lokacione. "Gjatë kontrollit janë gjetur dhe sekuestruar sasi e madhe e barnave, kartëmonedha euro, armë, substancë e dyshuar narkotike, katër vetura dhe dëshmi të tjera. Nën dyshim për përfshirje në veprat penale: 'Kontrabanda me mallra' dhe 'Dhënia e ryshfetit' janë arrestuar katër të dyshuar: A. L., viti i lindjes 1974, mashkull kosovar; A. L., viti i lindjes 1983, mashkull kosovar; L. B., viti i lindjes 1976, mashkull kosovar dhe F. S., viti i lindjes 1980, mashkull kosovar", thuhet në njoftim.

Sipas policisë, në rastin e dytë, pas hetimeve paraprake, nën dyshimin për përfshirje në veprat penale: 'Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar' dhe 'Ushtrim i ndikimit', hetuesit policorë kanë arrestuar të dyshuarin: R. B., viti i lindjes 1982, mashkull kosovar, (kryesues i Bordit të Drejtorëve - Trafiku Urban në Prishtinë). I arrestuari dyshohet se tejkalon autorizimet e tij dhe mundohet të ndikojë në vartësit e tij për pranim të një kandidateje në një konkurs punësimi", thuhet më tej në njoftim.

Ndërkaq në rastin e tretë në Drenas, hetuesit policorë, nën dyshimin e kryerjes së veprave penale "Falsifikim i dokumenteve" dhe "Mashtrim", kanë arrestuar të dyshuarin Xh. H., viti i lindjes 1962. Sipas njoftimit për media, i dyshuari gjatë gjashtë muajve (korrik-dhjetor 2019), derisa ishte nënkontraktor për pastrimin e veturave të policisë, ka arritur t'i falsifikojë shkresat rreth numrit të veturave të pastruara (shtim të numrit) duke shkaktuar një dëm në vlerë rreth 1 000.00 (një mijë) euro. Me aktvendim të prokurorëve kompetentë, gjashtë të dyshuarit janë dërguar në mbajtje për 48 orë.




# Fondi për sigurimin bujqësor, temë diskutimi në mes të Mustafës dhe Mazrekut

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) Sistemi i sigurimeve në sektorin e bujqësisë, është një komponentë thelbësore për një sektor më konkurrues, më produktiv e më fitimprurës në Kosovë. Kështu është shprehur ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, gjatë takimit me drejtorin ekzekutiv të Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, me të cilin kanë biseduar për rëndësinë e sistemit të sigurimeve në sektorin e bujqësisë në Kosovë, si dhe për avancimin e mëtejmë të këtij sistemi në vend. "Sigurimi i prodhimtarisë bujqësore është segment shumë i rëndësishëm për ta zhvilluar dhe avancuar sektorin e bujqësisë edhe më tej dhe për ta bërë atë më konkurrues", ka thënë ministri Mustafa.



Ai ka theksuar se një sistem i mirë i sigurimit bujqësor ndihmon padyshim edhe në rritjen e produktivitetit dhe profitabilitetit të fermerëve të Kosovës.

Në anën tjetër, drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, theksoi rëndësinë e sigurimeve në sektorin e bujqësisë, duke vlerësuar tashmë edhe lansimin e sistemit të sigurimeve në Kosovë. "Sistemi i sigurimeve në bujqësi ndikon edhe në forcimin e një mjedisi të përshtatshëm, duke rritur në këtë mënyrë edhe aftësitë teknike në zbutjen e rreziqeve që kërcënojnë këtë sektor", ka thënë ai.

Ndryshe, në fillim të vitit 2019, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC), anëtare e Grupit të Bankës Botërore, kanë lansuar sistemin e sigurimeve bujqësore në Kosovë.

# Prishet koalicioni LV - LDK në Prizren

Prizren 13 shkurt - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka bërë me dije të enjten se koalicioni në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës në Prizren tashmë është i pakuptimtë, pasi që LDK-ja nuk ka marrë pjesë në votimin e së enjtes për kryesues të Asamblesë Komunale, me ç'rast koalicioni LV - LDK e ka humbur mundësinë për ta udhëhequr asamblenë.
Haskuka ka thënë se asambleja komunale ka qenë arsyeja për të cilën kanë hyrë në koalicion, prandaj edhe nuk ka kuptim që koalicioni të vazhdojë tutje. "Së pari uroj që tashmë ka përfunduar procesi i zgjedhjes së asamblesë komunale, sepse më shumë se dy muaj janë duke u pritur më shumë se 20 vendime që do të duhej të votoheshin në asamblenë komunale. Po më vjen keq që LDK-ja nuk ka qenë e pranishme në votim dhe ne si koalicion e kemi humbur kryesuesin e asamblesë komunale. Arsyeja që kemi qenë në koalicion ka qenë asambleja komunale, për t'i kaluar vendimet më lehtë dhe për të pasur një bashkëpunim më të lehtë ndërmjet qeverisjes ekzekutive dhe legjislative në komunë. Me këtë humbje koalicioni ynë nuk ka kuptim, prandaj do të vazhdojmë vetëm në këtë aspekt", ka thënë Haskuka në konferencë për medie.
Kryesues i Kuvendit Komunal në Prizren është zgjedhur Sulltan Badalli nga PDK-ja.



# KEDS-i sivjet do të investojë në 70 projekte në Drenas



Drenas, 13 shkurt - KEDS-i ka diskutuar të enjten me zyrtarët komunalë të Drenasit për vazhdimin e projekteve investuese për vitin 2020 në këtë komunë. Këtë vit KEDS-i ka aplikuar për leje në komunë edhe për 70 projekte të tjera investuese që do t'i realizojë në Drenas.
Drejtori i Investimeve në KEDS, Hasan Oz, tha se janë të gatshëm që punimet t'i fillojnë gjatë muajit mars dhe pas përfundimit të tyre Drenasi do të kompletohet plotësisht. "Synimi ynë është që ta fillojmë punën qysh në muajin mars dhe në bashkëpunim me komunën t'i realizojmë projektet e parapara dhe me këtë t'i përmbyllim komplet punimet investive për Drenasin", tha ai.
Komuna e Drenasit është e para ku KEDS-i ka bërë shndërrimin e tensionit të rrjetit 10kV në 20 KV dhe ka ndërruar komplet strukturën energjetike që do ta përmirësojë dukshëm tensionin në këto anë.
Edhe zyrtarët e komunalë premtuan përkrahje dhe bashkëpunim të shkëlqyeshëm me strukturat e KEDS-it. "Kemi pasur takime të shpeshta dhe bashkëpunim të shkëlqyeshëm me zyrtarët e KEDS-it. Sot u pajtuam për vazhdimin e punëve që komuna jonë ta përmbyllë kapitullin e investimeve këtë vit", u shprehën ata.
KEDS-i gjatë vitit 2019 ka arritur të përfundojë 30 projekte investuese brenda në qytet dhe në shumë fshatra të kësaj ane.



# Prokuroria e Ferizajt ndalon katër persona

Ferizaj, 13 shkurt (ER) - Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka njoftuar se me urdhër të prokurorit kujdestar ka ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orësh katër persona të dyshuar me inicialet A. L., F. S., L. B., dhe A. L., për shkak të dyshimit të bazuar se të njëjtit kanë kryer veprat penale "Kontrabandimi i mallrave", nga neni 311. paragrafi 5, "Dhënia e ryshfetit", nga neni 422, paragrafi 2 dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). Prokurori i çështjes, ndaj të pandehurve, brenda afatit të caktuar ligjor, pritet të bëjë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit.

# Rruga Besi - Podujevë, me dinamikë të përshpejtuar të punimeve

Prishtinë, 13 shkurt (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir Abdixhiku, i shoqëruar nga ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, të enjten ka vizituar pikat në të cilat kanë ngecur punimet në zgjerimin e rrugës nacionale N25, Besi - Podujevë. Ministri Abdixhiku ka treguar se është bërë planifikim i ri financiar duke u ndarë mjete shtesë dedikuar këtij projekti në buxhetin e vitit 2020, me qëllim të zhvillimit të dinamikës së re të punimeve, që do ta përshpejtojnë përfundimin e tyre. Ai ka theksuar se njëjtë do të veprohet me të gjitha projektet madhore që janë në proces në mbarë Kosovën, ndërsa të rejat do të fillojnë vetëm kur të përfundojnë projektet e vjetra.



# Haxhiu takon Apostolovën: Fuqizohet planveprimi i përbashkët për reformën në drejtësi

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, me bashkëpunëtorët e saj, Nazlie Bala dhe Blerim Sallahu, ka pritur të enjten në takim shefen e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, me bashkëpunëtorë, Riccardo Serri, Cezary Michalczuk, Julia Jacoby dhe Aferdita Smajli, të cilët i uruan suksese ministres Haxhiu në detyrën e re. Me këtë rast, ministrja Haxhiu ka falënderuar Apostolovën për përkrahjen e vazhdueshme të Bashkimit Evropian për Kosovën, duke theksuar rëndësinë e vazhdimësisë dhe thellimin e këtij bashkëpunimi.

Ministrja Haxhiu e ka njoftuar shefen e Zyrës së BE-së me prioritetet kryesore të cilat do t'i ndërmarrë gjatë mandatit të vet dhe e ka siguruar se mbeten të përkushtuar për zbatimin e agjendës evropiane, përfshirë reformën në drejtësi, e cila do të ndiqet sipas standardeve ndërkombëtare dhe do ta shënojë kthesën e duhur në luftën e pandalshme kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

Gjatë takimit u garantua mbështetje e mëtejshme nga Zyra e Bashkimit Evropian, njëherësh u pajtuan për fuqizimin e instrumenteve bashkëpunuese përmes projekteve të përbashkëta për t'i avancuar më tej reformat që do ta forcojnë shtetin e së drejtës.



# Agjencia Kadastrale e Kosovës nënshkruan dy marrëveshje me homologët maqedonas

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) - Agjencia Kadastrale e Kosovës, si organ kompetent në fushën e kadastrës, gjeodezisë dhe hartografisë, si dhe me përgjegjësi për mirëmbajtjen e regjistrit të të drejtave të pronave të paluajtshme dhe për koordinimin e infrastrukturës kombëtare për informacione hapësinore, është pjesëmarrëse e nismave të ndryshme regjionale dhe ndërkombëtare brenda fushave të cilat i mbulon. Po ashtu, AKK-ja është edhe në zgjerim të vazhdueshëm të rrjetit të bashkëpunëtorëve si me institucione publike brenda Republikës së Kosovës, po ashtu edhe me institucionet homologe nga shtetet e regjionit dhe ato anëtare të BE-së.




Ndërsa me qëllim të thellimit të bashkëpunimit në fushat e interesit të përbashkët, të enjten në Agjencinë Kadastrale të Kosovës është mbajtur edhe një takim pune mes drejtorit ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti dhe drejtorit ekzekutiv të Agjencisë për Kadastër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Boris Tunxhev.

Në takim, dy prijësit e institucioneve të sipërpërmendura, të shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët e tyre nga fusha e kadastrës, gjeodezisë, hartografisë, teknologjisë së informacionit dhe nga ekspertë ligjorë, pos që kanë prezantuar aktivitetet, projektet e sfidat e institucioneve respektive, kanë nënshkruar edhe dy marrëveshje, respektivisht një Marrëveshje Bashkëpunimi dhe një Marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave nga rrjetet permanente gjeodezike KOPOS dhe MAKPOS, respektivisht shfrytëzimin e pikave të rrjetit permanent të Republikës së Kosovës (KOPOS) nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe shfrytëzimin e pikave të rrjetit permanent të Republikës së Maqedonisë së Veriut (MAKPOS) nga Republika e Kosovës, që do të mundësonte mbulueshmërinë me sinjal për aktivitete gjeodezike që kryhen në zonat e brezit kufitar mes dy shteteve.

Ndërsa sa i përket marrëveshjes për bashkëpunim, e njëjta specifikon fushat ku do të mund të thellohej bashkëpunimi mes institucioneve, si shkëmbimi i përvojave e ekspertizave, ofrimi i përkrahjes në fusha profesionale, harmonizimi i të dhënave gjeohapësinore e ngjashëm.

Menjëherë pas nënshkrimit të këtyre dy marrëveshjeve, ekspertët e Agjencisë Kadastrale të Kosovës mbajtën edhe prezantimin e dy projekteve të cilat ajo ka implementuar me sukses, ndërsa në shtetin fqinj pritet të implementohen në të ardhmen si Sistemi i Unifikuar i Adresave dhe përdorimi i fluturakes pa pilot (DRON) për matje kadastrale.

# Bajrami vizitoi Kamenicën dhe u informua me gjendjen pas reformave të filluara në arsim nga kjo komunë

KAMENICË, 13 SHKURT (ER) - Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, ka vizituar të enjten qytetin e Kamenicës, ku është takuar me kryetarin e kësaj komune, Qëndron Kastrati, shefat e grupeve parlamentare në Asamblenë Komunale dhe këshillat e prindërve të shkollave që janë prekur nga reforma e filluar në arsim nga ana e Komunës së Kamenicës.

Pas takimit me kryetarin Kastrati, ministrja Bajrami theksoi se zvogëlimi i numrit të nxënësve në klasa dhe në shkolla në përgjithësi është një fenomen që e ka prekur tërë Kosovën, veçanërisht komunën e Kamenicës, për shkak të shpërnguljes së banorëve. Megjithatë, ministrja theksoi se një prej kompetencave të Ministrisë është respektimi i kalendarit të vitit shkollor, të cilën e ka kërkuar nga kryetari Kastrati.

Ministrja Bajrami theksoi se MAShT-i është duke bërë një analizë të përgjithshme rreth gjendjes së numrit të nxënësve në shkolla në të gjitha komunat e Kosovës dhe theksoi se ministria dhe komunat duhet të veprojnë konform ligjeve në fuqi dhe kompetencave që dalin nga këto ligje. Më pas, ministrja Bajrami ka pasur një takim edhe me shefat e grupeve




parlamentare në Asamblenë Komunale, po ashtu edhe me këshillat e prindërve të disa shkollave, të cilat janë prekur nga reforma e filluar në Kamenicë, e që si rezultat prindërit kanë refuzuar t'i dërgojnë fëmijët në shkolla të tjera, pra nuk e kanë filluar gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor.

Ministrja i dëgjoi shqetësimet dhe pakënaqësitë e prindërve, ndërsa kërkoi nga ta gjitha palët bashkëpunim dhe gjetje të një zgjidhje, në mënyrë që fëmijët të mos dëmtohen nga kjo situatë e krijuar dhe të kthehen sa më parë në procesin mësimor.

Gjatë kësaj dite ministrja Bajrami ka vizituar edhe shkollën "Fan S. Noli" në Kamenicë, ku ka biseduar me menaxhmentin dhe mësimdhënësit dhe nxënësit e kësaj shkolle për kushtet në të cilat zhvillohet mësimi në këtë shkollë.

## Parlamenti i Sirisë njeh gjenocidin ndaj armenëve



DAMASK, 13 SHKURT - Të enjten, parlamenti i Sirisë, njohu si gjenocid vrasjen e deri në 1.5 milion armenëve nga ana e Perandorisë Osmane, gjatë viteve 1915-1917.
Vendimi vjen në kohën kur tensionet me Turqinë janë në pikën më të lartë, për shkak të luftimeve në verilindje të Sirisë.
“Parlamenti njeh dhe dënon gjenocidin e kryer kundër armenëve nga shteti otoman në fillim të shekullit XX”, tha parlamenti në një deklaratë.
Turqia është njëri nga aktërët kryesorë në konfliktin sirian, pasi mbështet forcat rebele që luftojnë kundër presidentit, Bashar al-Asad.
Turqit osmanë vranë dhe dëbuan rreth 1.5 milion armenë, një pakicë e krishterë në Perandorinë kryesisht myslimane, gjatë dhe menjëherë pas Luftës së Parë Botërore.
Shumë historianë dhe disa vende të tjera e konsiderojnë masakrën si gjenocid.
Turqia, një anëtare e NATO-s, ka kundërshtuar një përcaktim të tillë, duke pretenduar se vdekjet ishin më shumë rezultat i grindjeve civile sesa një përpjekje e planifikuar e Qeverisë osmane për të asgjësuar armenët.
Armenia thotë se vrasja masive është një nga shembujt e parë të gjenocidit në historinë moderne, përpara Holokaustit të kryer nga Gjermania naziste kundër më shumë se 6 milionë hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore.
Më 30 tetor, Dhoma e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara ka miratuar me shumicë votash një rezolutë, që e njeh si gjenocid masakrën ndaj armenëve në Perandorinë Osmane në fillim të shekullit të 20-të.

# Kandidati miliarder Bloomberg dhe shanset e tij për president

**Disa mbështetës të Michael Bloomberg besojnë se biznesmeni miliarder dhe ish-kryetari i bashkisë së Nju Jorkut është i vetmi kandidat demokrat që mund të mposhtë presidentin Donald Trump në zgjedhjet presidenciale të nëntorit**



AP

UASHINGTON, 13 SHKURT - Rezultatet e dy garave të para mes kandidatëve për president brenda Partisë Demokrate në ShBA, e kanë fragmentarizuar krahun e moderuar të partisë dhe nuk kanë nxjerrë një fitues të qartë.
Disa analistë e shohin këtë si një mundësi për fushatën e ish-kryetarit të bashkisë së Nju Jorkut Mike Bloomberg, e cila tani për tani është zhvilluar kryesisht në media.
Autobusi i fushatës Michael Bloomberg ishte këto ditë në Richmond të Virxhinias, duke tërhequr një grup mbështetësish të zjarrtë, të cilët besojnë se biznesmeni miliarder dhe ish-kryetari i bashkisë së Nju Jorkut është i vetmi kandidat demokrat që mund të mposhtë presidentin Donald Trump në zgjedhjet presidenciale të nëntorit, ka njoftuar voa.
“Ai mund ta bëjë këtë. Të tjerët do të shkualifikojnë veten e tyre. Është e tmerrshme. Trumpi do të na mundë fare lehtë nëse nuk kemi Bloombergun”, thotë Craig Hedley, votuesi i Partisë Demokrate.
Bloombergu nuk mori pjesë në garat e para në dy shtete mes demokratëve.
Në këto dy gara, senatori progresist i Vermontit Bernie Sanders ishte fituesi i votës popullore. Por axhenda e tij për ta bërë falas arsimin në universitete dhe kujdesin shëndetësor është parë nga shumë të moderuar si diçka polarizuese dhe ekstreme.
“Unë nuk mendoj se Sanders mund të ndërtojë një koalicion dhe ta mposhtë Trumpin. Neve na duhet dikush që mund të fitojë, një i moderuar”, thotë Deborah Hedley, votuese demokrate.
Pretendentët e moderuar - ish-kryebashkiaku i South Bendit në Indiana, Pete Buttigieg dhe senatorja e Minesotës Amy Klobuchar - janë paraqitur mirë, por mund ta kenë të vështirë tani që garat zhvendosen në shtete me më shumë votues të pakicave.
Ndërkohë, ish-nënpresidenti Joe Biden është paraqitur keq në dy garat e para.
Bloombergu, i cili po hyn në garë me vonesë, po e paraqet veten si një forcë bashkuese. Më parë ai ka qenë republikan.
“Unë garoj për ta bashkuar përsëri vendin, për të risjellë fjalën ‘të Bashkuara’ në emrin e vendit tonë Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, thotë Bloomberg.
Ish-kryebashkiaku ka fituar mbështetjen e disa drejtuesve partiakë, si kryetarja e bashkisë së Uashingtonit, Muriel Bowser. Ai gjithashtu ka dhuruar miliona dollarë për kandidatët demokratë dhe organizatat që luftojnë kundër ndryshimit të klimës dhe dhunës me armë.
Calandrian Simpson Kemp humbi të birin për shkak të dhunës me armë.
“Askush nuk kujdeset për fëmijët tanë, por mund t’ju përmend dikë që e bën. Emri i tij është Mike Bloomberg. Ai kujdeset”, tha ai.
Por Bloombergu është kritikuar për taktikën policore që zbatohej në kohën kur ishte kryebashkiak, me të cilën policia ndalonte njerëzit edhe kur nuk kishte dyshime serioze. Më vonë ai kërkoi falje për këtë taktikë që synonte pakicat.
“Tani e shoh që ne mund dhe duhet të kishim vepruar më shpejt për ta ndalur këtë taktikë. Më vjen keq që nuk e bëmë”, tha ai në fund të vitit të kaluar.
Fakti që Bloombergu po e financon me paratë e tij fushatën ka ngjallur kritika nga ana e kandidatit Sanders dhe të tjerë, që thonë se ai po përpiqet t’i blejë zgjedhjet.
E gjithë kjo do të vihet në provë kur Bloombergu të garojë në votimet e ‘Super të martës’ në muajin mars, kur gara të shtrihet në 14 shtete me elektorate të mëdha dhe të larmishme.

## OKB-ja miraton rezolutën për armëpushim në Libi

NJU JORK, 13 SHKURT - Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka miratuar një rezolutë duke bërë thirrje për “armëpushim afatgjatë” në Libi, ndonëse Rusia ka abstenuar votimin, pas kundërshtimeve që ka pasur në hartimin e dokumentit.
Rezoluta, që është hartuar nga Britania, është miratuar më 12 shkurt nga 14 pjesëtarë tjerë të Këshillit të Sigurimit, pas disa javëve të debatit.
Aty është theksuar “nevoja për armëpushim afatgjatë në Libi sa më shpejt, pa parakushte” dhe është shprehur “shqetësimi për rritjen e përfshirjes së mercenarëve në Libi”.
Rusia ka kërkuar që termi “mercenarë” të zëvendësohet me “luftëtarë të jashtëm terroristë”.
Moska, e cila mbështet gjeneralin, Khalifa Haftar, është akuzuar nga ekspertët e OKB-së se po u ndihmon kontraktorëve ushtarakë rusë që luftojnë për Ushtrinë Kombëtare të Libisë në krye me Haftarin.
Përveç Rusisë, gjenerali Haftar gëzon mbështetjen edhe të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Egjiptit.
Rusia ka mohuar zyrtarisht përfshirjen në luftën civile në Libi.
Ky vend është shkatërruar nga dhuna, prej kur udhëheqësi Muammar Gaddafi është larguar nga pushteti dhe më pas është vrarë më 2011.


Bebeto Matthews (AP)

# VEPËR QË SHUHET PËR VLERA TË VEÇANTA SHKENCORE

(Fadil Grajçevci, "Nëpër gjurmë të letërsisë", Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017)

Sadri FETIU

Fadil Grajçevci është studiues i dëshmuar i letërsisë shqipe. Ai është marrë edhe me studimin e letërsisë sonë të traditës, edhe me atë të letërsisë së sotme. Sukseset e para në historinë e lehtësisë shqipe i ka shënuar me studimin monografik të veprës së humanistit të njohur shqiptar, Marin Barletit. Është dalluar edhe si vlerësues i drejtë dhe studiues i mirëfilltë i vlerave të poezisë shqipe me studimin monografik kushtuar veprës poetike të Esat Mekulit. Ai këtë herë paraqitet para lexuesit shqiptar me një përmbledhje të veçantë studimesh, kritikash dhe recensionesh, me titull kuptimplotë "Nëpër gjurmë të letërsisë". Kjo përmbledhje përbëhet nga 30 njësi të veçanta që autori i ka ndarë në katër pjesë.

Dy pjesët e para, të cilat si vëllim përbëjnë gati dy të tretat e librit, kanë të bëjnë me studime historiko-letrare, që nisin me fillet e zhvillimit të letërsisë shqipe e shtrihen me shkëputje të ndryshme kohore deri ne kohën tonë, deri te veprat e njohura të prozës së sotme moderne e postmoderne. Brenda pjesës së parë të veprës janë trajtuar me kujdes të veçantë vlerat e veprave të Marin Barletit dhe të Frang Bardhit si në aspektin e theksuar të ideve frymëzuese, sidomos të veprës së Barletit për të gjithë pasuesit të tij dhe për lexuesit deri në kohën tonë, ashtu edhe të frymës kritike polemizuese të veprës së Frang Bardhit. Me rëndësi të veçantë për studimet historiko-letrare është qasja krahasimtare ndaj veprës së Barletit në relacion me poemën e njohur të Naim Frashërit kushtuar Skënderbeut, si edhe me studimin historik të Fan Nolit për heroin tonë kombëtar.

Në këto dy njësi studimore autori hedh dritë të plotë si për ndikimin e veprës së Barletit te këta dy autorë të njohur, ashtu edhe për angazhimet e veçanta të Naimit dhe të Nolit që në aspekte të dallueshme origjinale ndërmjet tyre i qasen lëndës së njëjtë, veprës së Barletit, qoftë si burim frymëzimi, qoftë si dëshmi argumentuese për veprat e tyre.

Ndërmjet studimeve të pjesës së dytë të librit vlen të dallohet ai për veprën dramaturgjike të A. Z Çajupit, e cila shquhet për idetë, vlerësimet kritike ndaj dukurive shoqërore ashtu edhe për strukturën estetike e gjuhësore që e përfaqësojnë këto drama si nismë e dramaturgjisë shqiptare që kishte një zhvillim të paktë deri në atë kohë. Mund të thuhet se dramat e Çajupit brenda kësaj vepre janë trajtuar për herë të parë në mënyrë të shumanshme. Në këtë pjesë të përmbledhjes me rëndësi të veçantë është edhe studimi për revistën letrare "Jeta e re", si për historikun e revistës, për botimin e letërsisë së traditës në të dhe, në mënyrë të veçantë, për prozën e A. Demaçit të botuar këtu. Edhe brenda kësaj pjese të veprës së F. Grajçevcit kemi një qasje krahasimtare ndërmjet poezisë së E. Mekulit dhe prozës së A Demaçit me anë të së cilës autori sjell plot njohuri të reja për veprat e këtyre dy autorëve.

Me një përkushtim të veçantë, krahas ndihmesës së E. Mekulit, për letërsinë e botuar në "Jetën e re", Fadil Grajçevci i ka trajtuar deri në hollësi pikëpamjet estetike-letrare të Mekulit jo vetëm në periudhën e fazës së parë sociale të krijimeve të tij poetike, por edhe me vonë në fazën e fundit të krijimtarisë së këtij poeti.

Në këtë pjesë të veprës së Fadil Grajçevcit shquhet edhe studimi i tij për Rexhep Qosjen - historian i letërsisë, si dhe përpjekja për ta trajtuar me sukses laboratorin krijues të këtij autori me anë të analizës së pjesës dokumentare të veprës së tij, në radhë të parë me anë të ditarit.

Duke u marrë me përvojat krijuese moderne dhe postmoderne në romanin shqiptar, ai do t'i kushtojë kujdes edhe analizës së romanit të Qosjes "Një dashuri dhe shtatë faje", si dhe romanit të Shefkije Islamajt "Mos më thuaj se më ke parë në ëndërr". Romanin e Shefkijes ai do të trajtojë përsëri edhe në pjesën e tretë të kësaj vepre me anë të recensionit "Ligjërimi magjik", që shquhet për qasje studiuese ndaj vlerave estetike-letrare dhe gjuhësore të kësaj vepre. Po këtu e gjejmë edhe një shkrim të shkurtër analitik për veprën gjuhësore të Shefkijes kushtuar kulturës së gjuhësore dhe përdorimit estetik të gjuhës. Brenda pjesës së tretë të veprës së F. Grajçevcit janë trajtuar me sukses edhe veprat e Hysen Matoshit "Poezia e Lasgush Poradecit në kontekstin e poezisë evropiane" dhe "Shpalime historike", pastaj vepra e Donikë Dabishevcit proza e poetizuar, ajo e Mehmet Gëzhillit kushtuar Fan Nolit etj.

Midis recensioneve shquhet sidomos ai për veprën e Feride Paplekajt për Dhimitër Shuteriqin, si edhe për studimin e Zija Xholit "Pesë mendimtarë të vjetër të kulturës sonë kombëtare", të cilat autori me të




drejtë i ka vlerësuar si vepra që sjellin njohuri të reja për letërsinë dhe për kulturën tonë kombëtare.

Në mesin e recensioneve bie në sy edhe analiza kritike e tekstit të Sabri Hamitit "Letërsia e vjetër shqipe për shkolla të mesme", për të cilin janë dhënë vërejtje të shumta për lëshimet dhe gabimet, si sa i përket anës përmbajtjesore, po ashtu edhe asaj gjuhësore.

Në pjesën e katërt të përmbledhjes "Nëpër gjurmë të letërsisë" të Fadil Grajçevcit janë përfshirë gjashtë njësi që përfaqësojnë shkrime sintetizuese si fjalë të rastit që u paraprijnë tubimeve shkencore qofshin ato tematike, përkujtimore apo jubilare. Në këto shkrime autori na ka dhënë vlerësime të përmbledhura, sinteza të thukëta për veprat e De Radës, të Dhimitër Shuteriqit, të Musine Kokolarit, të Bajram Krasniqit, të Sefedin Fetiut, si edhe në një fjalë hyrëse që i kushtohet romanit të sotëm shqiptar.

Edhe pse në dukje të parë këto njësi duken të thjeshta dhe krejt të rastit, që të gjitha shquhen për saktësinë e vlerësimit shkencor, për përzgjedhje të thelbit të vlerave të veprave të këtyre autorëve e në disa raste edhe për ndjeshmëri emocionale ndaj autorëve, si: Bajram Krasniqi dhe Sefedin Fetiu, që u ndanë nga jeta në moshë relativisht të re dhe mund t'i jepnin ndihmesa edhe më të mëdha studimit të letërsisë shqipe.

Duke përfunduar këtë recension të shkurtër për veprën e Fadil Grajçevcit, "Nëpër gjurmë të letërsisë", do të pohoj me bindje të plotë se vepra shquhet për vlera të veçanta shkencore, të cilat i karakterizojnë të gjitha llojet e këtyre shkrimeve për letërsinë tonë, se ajo është shkruar me një gjuhë të pastër e të pasur shqipe, me terminologji të saktë shkencore, me dashuri të veçantë për letërsinë dhe për kulturën tonë kombëtare. Vepra shquhet për vlerësimin e drejtë objektiv të veprimtarisë letrare të të gjitha autorëve që trajtohen në të. Me vlerë të veçantë janë studimet krahasimtare të veprave të autorëve të periudhave të caktuara letrare, qoftë për përbërësit e përbashkët tematikë, qoftë edhe për rrethanat e ngjashme kohore në të cilat janë krijuar këto vepra. Prandaj me të gjitha vlerat që i përmban, vepra do të jetë ndihmesë e veçantë për të gjithë studiuesit e letërsisë shqipe të traditës dhe të periudhës së sotme.

E jashtëzakonshme

## Zbulohen fosilet e një breshke gjigante, ka përmasat e një makine



Studiuesit kanë zbuluar fosilet e një breshke gjigante, e cila është në përmasat e një makine. Zbulimi është bërë në Amerikën e Jugut dhe mendohet që breshka ka jetuar 7-12 milionë vjet me parë. Ajo ishte e gjatë 3-4 metra dhe me peshë 1.25 ton, rreth 100 herë më shumë se gjysma e gjatësisë së breshkës së sotme.

FOTO E DITES




Në fotografi shihet helikopteri i qeverisë siriane që është qëlluar nga një raketë në provincën Idlib /AP/

E rrallë

## Një burrë gjerman bën propozimin e pazakontë për martesës, ai shfaqet në Google Maps




Propozimi për martesë i një burri gjerman mori një audiencë më të madhe nga sa kishte planifikuar, pasi u shfaq në një pamje ajrore të përdorur nga Google Maps. Agjencia gjermane e lajmeve "DPA" ka raportuar të mërkurën se fermeri 32-vjeçar me kohë të pjesshme Steffen Schëarz përdori një makinë për të mbjellë një arë misri në atë mënyrë që boshllëqet të formonin fjalët "A dëshiron të martohesh me mua?". Ai i tha për "DPA" se nuk e kishte menduar ose pritur që imazhi të shfaqej në shërbimin e hartave popullore të Google, deri sa një hallë që ka në Kanada ia dërgoi foton.

## BARSOLETA E DITËS



**E dashura: Qysh i fiton ti këto pare që po i harxhon?**
**Djali: Duke shkruar në telefon.**
**E dashura: Qysh kështu?**
**Djali: I shkruaj babës në Zvicër dhe i them se nuk kam para.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 18:00**

### Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno







**Në ora 18:00**

### Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
**Regjia:** Jake Kasdan

**Çdo natë në ora 20:00**

### STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
**Regjia:** J.J. Abrams







**Çdo natë në ora 22:30**

### THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Do të jeni të pakënaqur edhe në familje, kudo që të jeni dhe me këdo që të gjeni diçka për të cilën do ankoheni. Kujdesuni shumë për flokët tuaj, ato duhet të forcohen.



**DEMI**
Pranoni ftesa, merrni pjesë në ngjarje sociale, mos u mbyllni në shtëpi. Bëni aktivitete fizike.



**BINJAKËT**
Një zgjidhje e bujshme, pra, e cila gjithashtu do t'ju sjellë fitime të mira. Momentet e gëzimit dhe pasionit të madh do t'ju lidhin më tej me të dashurin tuaj. Nëse jeni beqarë, shikoni përreth, një person nuk heq sytë nga ju.



**GAFORRJA**
Është koha e përshtatshme për të marrë pak kohë për pushim dhe relaksim. Stimujt e papritur mund të tërheqin vëmendjen tuaj dhe t'ju bëjnë të hutoheni ndaj të dashurit tuaj, mos jepni atij shumë liri.



**LUANI**
Me Hënën tek Peshqit nuk mund të thuhet se kjo ditë do të jetë një çudi sentimentale. Prandaj kini kujdes. Një ngjarje e vogël e papritur mund të bëjë që ju të ndryshoni një angazhim të planifikuar për një kohë të gjatë.



**VIRGJERESHA**
Në familje dhe në marrëdhënien me partnerin tuaj ju duhet të sqaroni disa gjëra. Ajo që është më e rëndësishme është se marrëdhëniet tuaja me njerëzit janë shumë të forta dhe të palëkundshme.



**PESHORJA**
Në punë do të shkojë gjithçka vaj. Idetë tuaja mund të dallohen për origjinalitetin e tyre, si dhe për shpejtësinë me të cilën do të lindni çdo lloj iniciative. Lajme të reja në horizont.



**AKREPI**
Shumë probleme dhe situata të pakëndshme mund të zgjidhen falë këmbënguljes suaj, por edhe falë intuitave të papritura, e në disa raste do tregoheni si një gjeni i vërtetë.



**SHIGJETARI**
Dashuria është forcë, dëshirë, kujtesë! Do ringjallen marrëdhëniet sociale dhe disa takime biznesi mund të bëhen mjaft interesante. Koha juaj e lirë mund të shfrytëzohet për takime të reja.



**BRICJAPI**
Do të keni të reja në dashurinë private dhe familjare. Nëse keni lindur në shkurt do të keni më pak energji. Përdorni kreativitetin për të marrë kënaqësitë profesionale që ju meritoni.



**UJORI**
Ju jeni duke bërë projekte ambicioze dhe do t'i realizoni të gjitha. Hijeshia juaj sharmon dhe tërheq vëmendjen e të gjithëve. Do të përjetoni momente të ëmbla në dashuri.



**PESHQIT**
Sido që të jetë situata, ju keni hijeshi dhe karizëm, ide dhe imagjinatë të zgjuar, paratë tuaja do t'i shfrytëzoni për disa blerje të zgjuara. Ditë e bukur për punët sentimentale.

# Mbretëresha kërkon që Harry dhe Meghan të kthehen për një ngjarje mbretërore



Prince Harry, Meghan Markle dhe Archie ndoshta do të udhëtojnë për në Britani së shpejti. "Sunday Times" ka raportuar se Mbretëresha Elizabeth II kërkoi që Sussexes të bashkohen me pjesën tjetër të familjes mbretërore për Ditën e Commonwealth në Westminster Abbey në Londër muajin tjetër.
Kjo është vendosur të bëhet më 9 mars.
Çifti ndoqi të njëjtin shërbim vitin e kaluar së bashku me Princin William dhe Kate Middleton kur Meghan ishte në tremujorin e tretë të shtatzënisë.
Që nga largimi i tyre nga familja mbretërore dhe dorëheqja nga titujt mbretërorë, ata pritet të kthehen për angazhimet e tyre të fundit.

# Aktorja që luan rolin e Dianës rikrijon fustanin e saj ikonik





Emma Corrin, e cila luan Princeshën Diana në sezonin e katërt te "The Crown", ka rikrijuar skenën ikonike të udhëtimin të saj në 1989 në Nju Jork City. Aktorja ishte parë së fundmi në xhirime në Manchester, Angli, e cila u shndërrua në pamje të Nju Jork City. Ajo ishte e veshur me fustanin e rikrijuar mbretëror me rruaza që ajo veshi në një gala bamirësie në Akademinë e Muzikës në Brooklyn në shkurt të vitit 1989. Në këtë ngjarje, Princesha e Wales e ndoqi Operën Kombëtare të Wales duke interpretuar "Falstaff" të Verdiit, sipas Nju Jork Times.



# Sophie Turner shtatzënë, pret fëmijën e parë me Joe Jonas

Sophie Turner dhe Joe Jonas janë në pritje të fëmijës së tyre të parë së bashku. Një burim i tha "Just Jared", i cili raportoi për herë të parë këtë lajm, se çifti po i mban gjërat të fshehta, por "miqtë dhe familja janë shumë të lumtur për ta". Turner, 23-vjeçare dhe Jonas, 30-vjeçar, u martuan në një ceremoni të befasishme në Las Vegas në maj të vitit 2019 pas Billboard Music Awards.

# The Game nderon Bryant me tatuazh





The Game ka përkujtuar të ndjerin Kobe Bryant në çdo vend që shkon. Tash e tutje reperi ka zbuluar tatuazhin e ri në fytyrë në nderim të legjendës së NBA. Game e bëri tatuazh numrin tetë dhe autografin e Kobes mbi vetullën e tij të djathtë, i cili simbolizon "Kobe gjithmonë". Reperi i cili ende mban zi për humbjen e ikonës së L.A., ka planifikuar gjithashtu edhe një këngë në nderim të Bryantit dhe i ka veshur fanellat e tij gjatë turneut aktual..





Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Ylli kalon edhe Bashkimin, kualifikohet në finale

RAHOVEC, 13 SHKURT - Golden Eagle Ylli ka mundur Bashkimin me rezultat 79:69 (24:12, 14:23, 18:11, 23:23) për t'u kualifikuar në finale të Kupës së Kosovës në basketboll. Ylli e nisi ndeshjen për mrekulli, duke qenë në epërsi dhe çerekun e parë e përfundoi në të mirë të tij me rezultat 24:12. Por, Bashkimi u këndell në periudhën e dytë, duke u rikthyer në lojë, madje barazoi shifrat në 31:31, për të kaluar më pas në epërsi 33:35, por skuadra therandase shkoi në pushim me tri pikë epërsi 38:35. Në periudhën e tretë u zhvillua një lojë shumë interesante, derisa Ylli sërish e nisi më mirë, duke e fituar këtë pjesë 18:11,



derisa rezultati në semafor pas 30 minutash tregonte shifrat 56:46 për skuadrën nga Theranda. 10 minutat ishin tërësisht të barabartë, ku Ylli ruajti epërsinë e krijuar, derisa Bashkimi nuk arriti përmbysjen dhe në fund Golden Eagle Ylli triumfoi me rezultat 79:69, derisa në finale e pret fituesin e ndeshjes Rahoveci - Peja. Te Ylli u dalluan Devonte Browen me 17 pikë, Egzon Kuqi me 14, Jameel McKay me 10 pikë e 15 kërcime dhe Samir Zekiqi me 10 pikë e pesë kërcime, derisa te Bashkimi më të mirët në parket ishin Stevie Clark me 19 pikë, Corey Ross me 16 dhe Terik Bridgeman me 16.

### Vëllaznimi fiton Kupën në Ligën e Parë

Vëllaznimi është fitues i Kupës në Ligën e Parë, pasi në finale ka mundur AS Prishtinën me rezultat 66:72 (16:21, 18:17, 17:20, 15:14). Ndeshja ka qenë shumë interesante, ku skuadra kuqezi e nisi ndeshjen më mirë, duke e fituar çerekun e parë 16:21. Lojë më e barabartë u zhvillua në periudhën e dytë, që përfundoi 18:17 për AS Prishtinën. Edhe pjesa e dytë ishte kryesisht e barabartë, ku perioda e fundit përfundoi 17:20 dhe ajo e fundit 15:14, derisa Vëllaznimi triumfoi në fund me rezultat 66:72. Dion Haxhosaj me 13 pikë e 18 kërcime dhe Ermir Gashi me 13 pikë e 10 kërcime ishin më të dalluarit tek AS Prishtina, kurse te skuadra kuqezi u dalluan Arion Balluku me 21 pikë, shtatë kërcime e shtatë asistime dhe Bardh Rexha me 15 pikë e 10 kërcime.

# Karateistët synojnë pikë në Dubai për turneun kualifikues të Parisit

PRISHTINË, 13 SHKURT - Premierë Liga e Dubait 2020, që mbahet prej 14-16 shkurt 2020, është stacioni i radhës i karateistëve në rrugën drejt kualifikimit për në Lojërat Olimpike "Tokio 2020". Gara e Dubait të Emirateve të Bashkuara Arabe është një prej më të rëndësishmeve për mbledhjen e pikëve për normë olimpike.
Në Dubai vendin tonë do ta përfaqësojnë katër karateistët: Adelina Rama (-61 kg), Fortesa Orana (+68 kg), Elhami Shabani (-75 kg) dhe Herolind Nishevci



(+84 kg).
Sipas përzgjedhësit, Ylber Syla, synimet e tyre janë grumbullimi i sa më shumë pikëve për kualifikim në turneun kualifikues të Parisit, që vlen për kualifikim direkt në LO Tokio 2020. "Presim paraqitje të mirë. Forma e garuesve është e mirë. Synimi është të mbledhim edhe pikë për kualifikim në garën e Parisit, më pas synojmë kualifikimin për 'Tokio 2020'", ka thënë Syla për Komitetin Olimpik të Kosovës.
Turneu kualifikues Paris 2020 mbahet prej 8-10 maj të këtij viti. Për të marrë pjesë në këtë garë, garuesit tanë duhet të jenë në mesin e top 50 garuesve më të mirë në kategori në renditjen botërore. Pikërisht në Paris, karateistët i kanë shpresat më të mëdha për ta fituar normën olimpike pasi, bazuar në renditjen olimpike, shpresat janë shumë të vogla, pavarësisht se deri në përfundim të kualifikimit olimpik mbeten edhe garat e tjera si në Dubai, Salzburg, Rabat, Madrid e Moskë. Momentalisht Herolind Nishevci është i 26-ti në renditjen botërore, Elhami Shabani i 56-ti, Fortesa Orana e 29-ta dhe Adelina Rama e 90-ta.
Në Premierë Ligën e Dubait të premten garon Elhami Shabani, ndërsa të shtunën tre garuesit e tjerë: Herolind Nishevci, Fortesa Orana e Adelina Rama.

# 'Futbolli i Kosovës', monografia që dokumenton një shekull të futbollit të Kosovës

PRISHTINË, 13 SHKURT - Në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës të enjten është promovuar monografia "Futbolli i Kosovës" e autorit Azem Brovina. Brovina tregoi se ka punuar rreth tetë muaj për ta përpiluar në tërësi këtë monografi dhe iu kanë dashur rreth 800 orë për ta sistemuar materialin.
Sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu, ka thënë se monografia e Azem Brovinës nuk do të ishte e plotë pa pranimin e Kosovës në organizatat botërore të futbollit siç janë FIFA dhe UEFA.
Ndërsa sa i përket autorit të kësaj monografie, ai u shpreh se Brovina asnjëherë nuk është ndikuar nga asnjë qeveri apo asnjë grup tjetër.
Ndërsa drejtori i Departamentit të Sportit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ibër Alaj, u shpreh se ministra e ka mbështetur këtë monografi në maksimum, duke ditur rëndësinë e këtij



botimi. Ndryshe, monografia "Futbolli i Kosovës" për shumë arsye është e veçantë, pasi është e shkruar mjeshtërisht, e argumentuar me gjuhën e fakteve dhe të statistikave dhe, si e tillë, i tejkalon kornizat e një historie sporti. Monografia e Brovinës, në fakt, është historia gjithëpërfshirëse e futbollit tonë, e cila, si e tillë, ka qenë hallkë e munguar e kronikës njëshekullore të Kosovës.

## Sot prezantohet përzgjedhësi Christos Marmarinos

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar se sot (e premte) nga ora 14:00 në zyrat e FBK-së do të mbahet konferencë për media, ku do të prezantohet përzgjedhësi i Kosovës, Christos Marmarinos. "Në këtë konferencë do të publikohet lista e gjerë e Kosovës për dy ndeshjet parakualifikuese për Botërorin e vitit 2023", thuhet në njoftimin e FBK-së. Kosova më 20 shkurt do të ndeshet me Islandën në Prishtinë, kurse më 23 shkurt "Dardanët" janë mysafirë të Luksemburgut. Në konferencë do të flasin edhe kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe drejtori i përfaqësuesve, Granit Rugova.



## Shala largohet nga Ferizaj, prezantohet te Gjilani



GJILAN, 13 SHKURT - Skuadra e Gjilanit e ka prezantuar të enjten Adenis Shalën. Futbollisti ishte pjesë e Ferizajt në stinorin vjeshtor, kurse në pranverë do t'i mbrojë ngjyrat e skuadrës nga Superliga. "Adenis Shala, 21-vjeçar, në skuadrën e Gjilanit vjen me përvojën gjashtëmujore në skuadrën e Ferizajt, i cili nga 16 ndeshje të zhvilluara kishte realizuar dy gola në pjesën vjeshtore të kampionatit me ekipin ferizajas", thuhet në njoftimin e Gjilanit. Shala më parë ishte paraqitur edhe për Feronikelin, Flamurtarin dhe Vëllaznimin, kurse në përvojën e tij jashtë Kosovës, futbollisti i ri kishte pasur paraqitje për skuadrat e Hajdukut të Splitit dhe Fenerbahçes duke mbrojtur ngjyrat e skuadrave të moshave në ekipet e lartcekura.

# Coronavirusi në Kinë, nuk anulohen Lojërat Olimpike




TOKIO, 13 SHKURT - Coronavirusi i shpërthyer në Kinë ka ndezur sinjalet e alarmit në mbarë botën dhe këtu përfshihet edhe ajo sportive. Së fundmi është folur për mundësinë e anulimit të Lojërave Olimpike në Tokio që do të zhvillohen këtë vit dhe kjo ndodh kur kanë mbetur edhe 162 ditë nga ceremonia e hapjes së ngjarjes më të rëndësishme sportive, por Komiteti Organizativ nëpërmjet presidentit të tij, Yoshiro Mori, mohoi zërat pas një takimi të zhvilluar me zyrtarët e lartë të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar. Mori theksoi se zërat e shfaqura në lidhje me këtë çështje janë prej të papërgjegjshmish dhe se askush nuk po mendon t'i shtyjë apo të anulojë Lojërat Olimpike. Ai shtoi se Komiteti Organizativ do të donte të bashkëpunonte me qeverinë japoneze dhe të veprohej me shumë qetësi. Ndërkaq, për shkak të coronavirusit janë bërë një sërë ndryshimesh në kalendarin e ngjarjeve sportive në kontinentin aziatik dhe këtu përfshihen kualifikueset për në olimpike në boks dhe basketboll, të gjitha në Kinë. Ndërkaq Çmimi i Madh i kinës në F1 u shty, por në rrezik është edhe gara e Vietnamit. Nga ana e tij, Guvernatori i Tokios, Yuriko Koike, premtoi marrjen e masave rigoroze për t'i mbrojtur njerëzit nga coronavirusi gjatë përgatitjeve për Lojërat Olimpike.

# Lakersat e fitojnë duelin ndaj Denverit, humbje surprizë nga Milwaukee



DENVER, 13 SHKURT - Lakersat arritën një fitore të rëndësishme në fushën e Denverit me shifrat 120-116, ndeshje e vendosur në kohën shtesë e ku përballë ishin dy ekipet më të mira në Perëndim. Një përballje e fortë, ku për Lakersat u dalluan LeBron James me një "triple double" (33 pikë, 12 rebounde e 14 asistime) e Anthony Davis 33 pikë e 10 rebounde. Një dyshe që bëri diferencën në parket, duke i bërë të pavlefshme 32 pikët e 10 asistimet e Murray për Nuggets (Jokiqi e mbylli me 22 pikë e 11 rebounde). Falë këtij suksesi Lakersat thellojnë diferencën në renditje me Denverin. Surprizë humbja e Milwaukees në Lindje, skuadra me rekordin më të mirë në NBA këtë sezon (46 tore e 8 humbje). Skuadra e Bucksit u mund me rezultat 118-111 nga Indiana, me vendasit që dominuan në ndeshje gjatë gjithë kohës. Të gjithë titullarët e Indianas realizuan mbi 13 pikë (Warreni 35 pikë, shënuesi më i mirë), ndërkohë që mungesa e MVP-së, Giannis Antetokounmpo, u ndie te miqtë, që nuk kishin një lider në fushë. Humbet edhe ekipi kampion i Torontos, që u mund 101-91 nga Brooklyni, me LaVert që ishte shënuesi më i mirë, autor i 20 pikëve. Pas kohës shtesë fiton edhe Orlando, 116-112 ndaj Detroitit, sfidë ku u dallua Gordoni me 25 pikë. Pa probleme fiton skuadra e Dallasit që, falë 33 pikëve e 12 rebounde të Luka Donqiqit, e mundi 130-111 Sacramenton. Vijon momenti i mirë për Utah Jazzin, që mposhti 116-101 Miamin (Mitchell, 26 pikë), ndërsa Charlotte fitoi 115-108 ndaj Minnesotas (Graham, 28 pikë).

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Cleveland - Atlanta | 127-105 |
| Orlando - Detroit | 116-112 |
| Brooklyn - Toronto | 101-91 |
| Indiana - Milwaukee | 118-111 |
| New York - Washington | 96-114 |
| Memphis - Portland | 111-104 |
| Minnesota - Charlotte | 108-115 |
| Dallas - Sacramento | 130-111 |
| Phoenix - Golden State | 112-106 |
| Utah Jazz - Miami | 116-101 |
| Denver - Lakers | 116-120 |

## SHKURT

### Ziyech, transferimi i parë nga Lampard

Hakim Ziyech pritet të jetë goditja e parë në merkato e Frank Lampardit, që nga momenti që ish-mesfushori ka marrë drejtimin e Chelseat. Një fakt të tillë duket se e ka konfirmuar edhe trajneri aktual i marokenit, Erik ten Hag. Tekniku i Ajaksit ka konfirmuar në një farë mënyre se talenti Ziyech do të transferohet te Chelsea në përfundim të këtij sezoni. Më herët mediat holandeze kishin shkruar për një marrëveshje mes dy klubeve mbi bazën e 37.8 milionë paundëve për kalimin e 26-vjeçarit në Premierë Ligë në merkaton e verës. Hakim Ziyech ka shënuar 8 gola dhe ka dhënë 21 asistime në të gjitha kompeticionet në këtë sezon, duke qenë një nga lojtarët më të rëndësishëm të Ajaksit.

### Scaloni: Messi është i njëjti, si tek Argjentina ashtu edhe te Barcelona

I vetmi peng i Lionel Messit në karrierën e tij të mbushur me suksese, rekorde dhe trofe, është padyshim një sukses me Argjentinën, që nuk ka mundur ta arrijë deri më tani. Gjithmonë ka pasur polemika, ku shpesh ylli i Barçës është akuzuar se te katalanasit vlerat e tij rriten nga ekipi. Lidhur me këto zëra ka folur së fundmi edhe trajneri i Argjentinës, Lionel Scaloni, i cili është shprehur hapur që Messi është i njëjtë si te Barcelona si tek Argjentina. "Messin e shoh mirë. Në ndeshjen e fundit ndaj Betisit ishte më i miri në fushë, edhe pse nuk shënoi gol. Dhuroi tre asistime dhe ishte gjithnjë i rrezikshëm. E shoh që është komod njësoj, si te Kombëtarja si te Barcelona. Fiksimi i Messit për të fituar me Argjentinën? Nuk ka të bëjë me klasifikimin. Të gjithë duan të fitojnë, sidomos me kombëtaret. Si Messi, edhe ne të gjithë duam të fitojmë".

### Joshua: Fury do ta rrahë Wilderin

